1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
  - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.



---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës .....	
Shtojca 2. Lista e Çmimeve të Sherbimeve .....	
Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës .....	
Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial.....	
Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike .....	
Shtojca 6. Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit .....	
Shtojca 7. Termat e referencës	
Shtojca 8. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve .....	
Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....	
Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit .....	
Shtojca 11 - Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak) .....	
Formulari 12 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)	
Shtojca 13 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)	
Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)	

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  2. Njoftimin e Kontrates;
  3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
  5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
<b>Shërbimi</b>	<b>Përshkrimi i shërbimi</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total për shërbim(3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Shërbimet)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					
<b>Datë</b> _____					

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

---

#### Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

---

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

## Mirëmbajtja vjetore e Sistemit Integrated Web Briefing dhe trajnimi i stafit

### Referencat

**Dokumenti është përpiluar duke përdorur si referenca edicionet e përditësuara të dokumentave të mëposhtëme:**

Aneksi 15 i ICAOs

ICAO doc AIM 10066

ICAO Doc 4444

EUROCONTROL Integrated Initial Flight Plan Processing System (IFPS) manual

AIP Albania GEN 3.1.5, ENR 1.10, 1.2.14; 1.3.2.4; 3.4.

AIS Operations Manual

### Përshkrimi i përgjithshëm

Albcontrol sh.a. është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të navigimit ajror në hapsirën ajrore të Republikës së Shqipërisë. Ndër shërbimet e ofruara nga Albcontrol është edhe Shërbimi i Informacionit Aeronautik që siguron të dhënat dhe informacionin aeronautik të nevojshme për sigurinë, rregullsinë dhe efikasitetin e lundrimit ajror në një formë të përshtatshme për të përmbushur kërkesat operationale të ATM si dhe të operatorëve ajrorë.

Një ndër funksionet e Shërbimit të Informacionit Aeronautik është edhe pranimi, verifikimi, procesimi, transmetimi e planeve të fluturimit dhe mesazheve shoqëruese të tyre, ofrimi i informacionit aeronautik dhe i buletineve të paraflyturimit për operatorët ajrorë. Për këtë qëllim Albcontrol ka në përdorim një sistem kompjuterik i emërtuar Integrated Web Briefing (IWB), për të

---

cilin është i nevjoshëm prokurimi i shërbimit të mirëmbajtjes vjetore që konsiston në sigurimin e suportit teknik në rast problemesh, përditësimin e moduleve të tij në versionet më të fundit sipas kërkesave teknike dhe të operimit si dhe trajnimin e stafit përkatës teknik dhe operacional. Sistemi bazohet në platformë WEB, i hostuar në Windows Server OS dhe Linux OS. Teknologjia e përdorur për krijimin e aplikacioneve është PHP, Javascript, IIS Web Servers, .NET, MySql Server.

Sistemi përmbush kërkesat e ICAO Doc 4444 dhe EUROCONTROL (IFPS) për planet e fluturimit dhe mesazhet shoqëruese të tyre. Sistemi mundëson marrjen e NOTAM-eve dhe mesazheve Meteorologjike për hapsirën ajrore shqiptare TAF dhe METAR. Gjithashtu sistemi proceson të dhënat aeronautike në formatin AIXM dhe mundëson paraqitjen vizuale të tyre.

Termi "Ofertues" në këtë dokument i referohet kandidatëve që do të marrin pjesë në tender që do të ofrojnë shërbimet sipas specifikimeve, dhe termi "Blerës" i referohet ALBCONTROL.

### **Specifikimet për përmbushjen e kërkesave operationale dhe teknike**

Ofertuesi duhet të deklarojë përmbushjen e të gjitha kërkesave të specifikimeve teknike të "Blerësit" në një tabelë pajtueshmërie.

Ofertuesi duhet të përshkruajë në mënyrë të detajuar shërbimin e mirëmbajtjes për komponentët e sistemit për 12 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Shërbimi i mirëmbajtjes duhet të përfshijë kontrole periodike të sistemit, si dhe perpilimin e raporteve përkatëse, gjatë-mujore dhe vjetore të cilat do të japin një përshkrim të përgjithshëm të performancës dhe gjëndjes së tij.

Nëse konstatohet që sistemi IWB nuk është i përditësuar tërësisht ose pjesërisht Ofertuesi duhet të përditësojë sistemin në versionin më të fundit të vlefshëm.

Për çdo përditësim të planifikuar të sistemit ose instalim të një versioni të ri Ofertuesi duhet të njoftojë minimumi 1 muaj përpara datës së implemetimit shoqëruar me të gjithë dokumentacionin përkatës, manuale operimi dhe instruksione.

Në rast se këto ndryshime kanë efekt në ndërfaqen e përdoruesit nga ana e Ofertuesit duhet të bëhet familjarizimi i stafit të operimit me ndryshimet e reja nëpërmjet trajnimit përkatës përpara futjes në operim të ndryshimeve.

Në rastin e instalimit të një versioni më të avancuar të sistemit Ofertuesi duhet të paraqesë një plan të sistemit, ku tregohet logjika e operimit të sistemit dhe ndërveprimi midis komponentëve të tij, në rast se ka ndryshime nga versioni aktual.

Çdo version i ri i instaluar duhet të garantojë përmirësim të funksionaliteteve ekzistuese të sistemit dhe mundësisht shtimin e funksionaliteteve të reja.

Pas instalimit duhet të kryhet testi i pranimit. Blerësi do të kryejë vlerësimin i sigurisë së operimit (Safety Assessment) para hyrjes në operim.

Gjate testeve, Blerësi rezervon të drejtën të propozojë ndryshime në sistem në formë, shfaqje dhe llogjikën e operimit të sistemit.

Në rast të implementimit të ndryshimeve në sistem Ofertuesi duhet të sigurojë një plan të detajuar implementimi që të përfshijë elementët e mëposhtëm:

Të gjitha punët/detyrat dhe aktivitetet për implementimin e tij;

Datat e implementimit dhe sasi të ditëve për çdo punë ose aktivitet;

---

Burimet e kërkuara (të Ofertuesit dhe të Blerësit).

Trajnimi/familjarizimi i stafit përkatës me ndryshimet e implementuara.

Ofertuesi duhet të dorëzojë një kopje elektronike të plotë të komponentëve të sistemit në media të përshtatshme elektronike që të jenë të përshtatshme për transferimin dhe ruajtjen e tyre për ri-instalim në rast dëmtimi të versionit të instaluar për shkak të korrupsionit të paketës software apo hardware. Ofertuesi duhet të specifikojë mënyrën e dorëzimit.

Ofertuesi duhet të sigurojë një ndërfaqe ku të dhënat dhe informacioni aeronautik të përditesohen nga ana e stafit të AIS-it. Sistemi duhet të mundësojë ngarkimin e të dhënave aeronautike në formate të ndryshme si AIXM 4.5, AIXM 5.1, CSV, etj.

Sistemi duhet të jetë kompatibël me versionet më të fundit të web browsers më të njohur në treg si Edge, Firefox, Chrome, etj.

Në rast se raportohet nga blerësi që sistemi shfaq probleme kompatibiliteti me browserat Ofertuesi në varësi të klasifikimit të defektit duhet ta riparojë atë brenda një periudhe kohore siç përcaktohet në këtë dokument.

Stafi përgjegjës i Blerësit duhet të ketë akses të plotë në faqen e internetit të AIS për krijimin e faqeve, përditësimin dhe fshirjen e tyre (si p.sh. të ketë mundësi të integrojë në faqen aktuale të internetit, faqen e publikimit të AIP dhe setet e të dhënave aeronautike). Ky akses duhet të sigurohet edhe nëse ka përfunduar afati i kontratës së mirëmbajtjes.

Gjithashtu Ofertuesi duhet të bëjë funksionale lidhjen e IWBS me AFTN.

Ofertuesi duhet të realizojë lidhjen teknike për marrjen e informacioneve meteorologjike (MET) për hapsirën ajrore të Republikës së Shqipërisë (Tirana FIR) që të përfshihen në buletinet e parafluturimit.

Ofertuesi duhet të kryejë kontrollin e vazhdueshëm të sistemit në bashkëpunim me stafin përgjegjës të Blerësit. Në raste kur shihet e arsyeshme qoftë nga Ofertuesi ose nga Blerësi mund të kryhen kontrole të planifikuara paraprakisht.

Kontrollet e planifikuara do të përfshijnë veprimet e mëposhtme:

Kontrolli i integritetit të bazës së të dhënave.

Kontrolli i cilësisë së të dhënave dhe paraqitja e tyre vizuale.

Kontrolli i strukturës së direktorive.

Inspektimi i mjedisit operacional dhe testues.

Kontrolli i të gjithë komponentëve të sistemit përfshirë SW të paleve të treta si Sistemet e Operimit, ose programe të tjerë në përdorim.

Analizimi i Log files.

Në fund të kontrollit të planifikuara Ofertuesi duhet të përpilojë një raport përmbledhës mbi rezultatet e kontrollit dhe për masat që duhen marrë për të bërë përmirësimet e nevojshme nëse nga kontrolli rezulton që është e nevojshme diçka e tillë.

Ofertuesi duhet të ndërmarrë veprime për të zgjidhur të gjitha problemet që mund të zbulohen gjatë Penetration Testing të kryer nga Albcontrol si dhe nga informacionet që publikohen nga prodhuesit



---

e komponentëve të sistemit mbi problemet që mund të shfaqen gjatë përdorimit dhe që mund të kompromentojnë sigurinë e sistemit.

Ofertuesi duhet të ofrojë formë të dytë autentikimi për mbrojtje nga sulmet kibernetike. Forma e dyfishtë e autentikimit mund të realizohet nëpërmjet verifikimit të përdoruesit me konfirmim kodi të posaçëm të dërguar me email ose sms.

Në rast kur implementohet një version i ri i sistemit Ofertuesi duhet të paraqesë Cyber Security Declaration, EC Declaration of Conformity dhe Declaration of SWAL conformity.

Shërbimet web të sistemit të implementuara në pjesën publike (të aksesueshme nëpërmjet internetit) duhet të jenë koduar në mënyrë të sigurtë për t'u mbrojtur nga sulmet kibernetike duke respektuar "OWASP Top 10" si më poshtë:

A01:2021-Broken Access Control.

A02:2021-Cryptographic Failures.

A03:2021-Injection.

A04:2021-Insecure Design.

A05:2021-Security Misconfiguration.

A06:2021-Vulnerable and Outdated Components.

A07:2021-Identification and Authentication Failures.

A08:2021-Software and Data Integrity Failures.

A09:2021-Security Logging and Monitoring Failures.

A10:2021-Server-Side Request Forgery.

Ofertuesi duhet të bëjë përmirësimin e pajisjeve hardware kur lind e nevojshme për shkak të ndryshimit të kërkesave të komponentëve të sistemit për të ruajtur performancën e tij.

Çdo ndryshim i kryer në pajisjet Hardware dhe Network duhet të dërgohet tek Blerësi në format elektronik dhe letër për aprovim. Pas aprovimit nga të dy palët do të nisë faza e implementimit.

Dokumentacioni duhet të përmbajë çdo ndryshim që pësojnë pajisjet apo rrjeti ekzistues.

Blerësi rezervon të drejtën e përcaktimit të vendit ku do të vendosen pajisjet në ambientet e tij.

Përpara futjes në operim të një versioni të ri të sistemit IWB, softwarëve mbështetës ose të pajisjeve të reja hardware, ato duhet të jenë plotësisht të testuara me dokumentacionin përkatës përfshirë raportin e vlerësimit të sigurisë operacionale nga Blerësi.

Në rast të implementimit të ndryshimeve të reja të pajisjeve hardware ato duhet të jenë të tilla që pjesët rezervë dhe njësitë e zëvendësueshme të ndërrohen dhe montohen lehtësisht.

Çdo përmirësim i pajisjeve hardware duhet të jetë kompatibël me AC 220V. Të gjitha pajisjet duhet të jenë të mbrojtur nga tensioni i lartë dhe duhet të jenë të tokëzuara në mënyrë të përshtatshme.

Ofertuesi duhet të përshkruajë një plan rikthimi në gjëndje pune të detajuar në rastet e problemeve teknike.

Klasifikimi i defekteve të sistemit që mund të konstatohen gjatë periudhës së mirëmbajtjes është si më poshtë:

<b>Kritik</b>	Defekti shkakton daljen jashtë funksionit të sistemit dhe ndërprerjen e plotë të shërbimit ndaj përdoruesve.
<b>Madhor</b>	Defekti shkakton mosfunksionimin e plotë të sistemit dhe ndërprerjen e pjesshme të shërbimit ndaj përdoruesve. Shërbimi mund të ofrohet në mënyra të tjera alternative.
<b>I Vogël</b>	Defekti nuk shkakton daljen jashtë funksionit të sistemit dhe është i mundur ofrimi i shërbimit ndaj përdoruesve.

**Koha e përgjigjes për kthimin në gjëndje pune sipas tipit të defektit të ndodhur:**

**Tipi i defektit Koha e Përgjigjes**

<b>Kritik</b>	< 1 orë
<b>Madhor</b>	< 5 orë
<b>I Vogël</b>	< 2 ditë

Ofertuesi duhet sigurojë suport 24/7 dhe koha e përgjigjes të jetë në përputhje me tabelën e mësipërme.

Koha e përgjigjes do të fillojë pas marrjes së raportit të defektit nga Ofertuesi dhe pasi aksesimi në distancë të jetë mundësuar nga Blerësi.

Në raste të ndërprerjes së shërbimit, nga Ofertuesi duhet të sigurohet funksionaliteti që në faqen e internetit të shfaqet një mesazh, i cili u tregon përdoruesve që sistemi është në mirëmbajtje ose jashtë funksionit.

Zgjidhja nëpërmjet aksesit në distancë do të jetë subjekt i pëlqimit paraprak të Blerësit.

Pas rikthimit të sistemit në gjëndje optimale duhet të përpilohet një raport i detajuar për natyrën, shkaqet e ndodhjes dhe masat e nevojshme për mospërsëritjen e të njëjtit problem në të ardhmen. Raporti duhet të miratohet nga të dy palët.

Ofertuesi duhet të paraqesë një plan të ku të përshkruhen të gjitha afatet kohore për aktivitetet kryesore të mirëmbajtjes.

**Trajnimi i stafit përkatës**

---

Ofertuesi duhet të paraqesë paketën e trajnimit për stafin teknik përgjegjës për mirëmbajtjen e sistemit (COM, SMC dhe IT) dhe stafin operacional (ARO dhe Sektori i Publikimeve). Trajnimi duhet të kryhet në ambjentet e Blerësit në grupe të veçanta.

Trajnimi duhet të zhvillohet në gjuhën Angleze.

Trajnimi i stafit operacional duhet të përfshijë rifreskimin e njohurive për operimin e IWBS, për marrjen, procesimin e planeve dhe mesazheve shoqëruese të tyre, krijimin e buletineve të parafluturimit si dhe për funksionalitet të tjera të sistemit të nevojshme për kryerjen e detyrave funksionale. Trajnimi i stafit të Sektorit të Publikimeve duhet të përfshijë përditësimin e të dhënave dhe të informacionit aeronautik në IWB. Trajnimi i stafit teknik për mirëmbajtjen e sistemit nga ana teknike duhet të përfshijë njohjen, instalimin, konfigurimin dhe riparimin e komponentëve të tij.

Gjithashtu Ofertuesi duhet të japë detaje për infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e trajnimit për çdo pjesëmarrës.

Ofertuesi duhet të paraqesë të gjitha detajet mbi përmbytjen e trajnimit të stafit teknik dhe operacional si dhe shtrirjen kohore të tij.

Në përfundim të kursit të trajnimit pjesëmarrësit duhet pajisen me çertifikatën përkatëse. Çertifikata duhet të ketë të shënuar datën e lëshimit të saj. Një kopje e kësaj çertifikate duhet ti dërgohet ALBCONTROL sh.a.

Trajnimi duhet të kryhet përpara futjes në operim të versionit më të fundit .

## **Garancia**

Ofertuesi duhet të sigurojë një garanci prej 12 mujash për sistemin IWB subjekt i kontratës së mirëmbajtjes, periudhë e cila fillon nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Pas përfundimit të periudhës të kontratës së mirëmbajtjes Ofertuesi duhet të sigurohet që sistemi duke përfshirë të gjithë komponentët e tij përbërës është në gjendje funksionale në versionin e fundit të përditësuar. Sistemi duhet të jetë në gjendje që të përditësohen të dhënat dhe informacionet aeronautike (AIP, NOTAM, MET, SDO/SDD AIXM 4.5, 5.1, etj.).

## **Dokumentacioni**

Dokumentacioni mbi sistemin IWB duhet të ofrohet në gjuhën angleze me grafike dhe diagrame. Dokumentacioni duhet të sigurohet në format letër ose elektronik.

Dokumentacioni duhet të përfshijë manualët e instalimit, manualët e përdorimit, manualët e mirëmbajtjes, skemën logjike të funksionimit të sistemit duke përfshirë të gjithë komponentët përbërës të tij dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm.

---

## **Shtojca 6**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### **FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

**Shërbimet që kërkohen që kërkohen:** Mirëmbajtja vjetore e aplikacionit Integrated Web Briefing dhe trajnimi i stafit

**Afatet e ekzekutimit:** 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës

---

**Shtojca 7**

*( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

**TERMAT E REFERENCES**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Mirëmbajtja vjetore e aplikacionit Integrated Web Briefing dhe trajnimi i stafit

Detyrat: Sipas shtojces se specifikimeve teknike

Shpërndarja: Sipas shtojces se specifikimeve teknike

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Sipas shtojces se specifikimeve teknike

---

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

---

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar në stafin e tij minimumi 6 persona për 3 (tre) muajt e fundit nga data e fillimit të kësaj procedure, ku ndërto të figurojnë:

- Inxhinier Elektronik 1 (një)
- Inxhinier Teknologji Informacioni 1 (një)

Për secilin prej pjestarëve të stafit teknik ofertuesi duhet të paraqesë diplomat përkatëse, si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërise për periudhen e lartpërmendur

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të provojnë përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale objekt kontrate*

---

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku xhironja vjetore për 3 vitet e fundit financiare (2019-2020-2021), ku vlera e xhiron për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit

2.2.2 Bilancet e viteve (2019-2020-2021) miratuar nga organet perkatëse shtetërore. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** *Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar*

## 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrata ku të ketë realizuar shërbime të ngjashme, në një vlerë sa 20 % e fondit limit që prokurohet, të realizura gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për përvoja të mëparshme të realizuar me sektorin publik, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetimi të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar përvojë e ngjashme të jenë në vlerën jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat që vërtetojnë përputhshmërinë me standardet:

- **ISO 9001:2015**, Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmerisë.

- **ISO 200001: 2018**, Menaxhimi i shërbimit IT ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmerisë.



---

- **ISO/ IEC 27001-2013**, Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë Informatike ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmerise.

Certifikatat duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH, ose ekuivalente me to.

*Argumentimi:* Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Sqarojmë se Albcontrol sha, operon në një fushë që është shumë specifike “Navigimi Ajror”, sipas rregullores Europiane 1035/2011 dhe të audituar nga ana e Agjensisë Europiane të Sigurisë së aviacionit (EASA) çdo dy vjet, ndërkohe sistemet me të cilët operon duhet të jenë komptibël me kërkesat e rregullatorëve ndërkombëtarë të Aviacionit Civil sipas Rregullores se Komisionit Europian EC 552/2004 si dhe kërkesave të tjera që kanë të bëjnë me sigurinë dhe përputhshmërinë me rregulloret si dhe me sistemet e tjera që janë operative.

Kërkesa për certifikime sipas standardeve ISO janë ne vetvete nje garanci me teper per suksesin e projektit dhe ne lidhje me cilesine e produktit dhe sherbimeve.

2.3.3. Operatori Ekonomik, duhet të paraqesë autorizim prodhuesi nga prodhuesi ose nga distributoret e autorizuar, apo të tjerë lejuar/certifikuar/autorizuar nga prodhuesi për Integrated Web Briefing. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, gjithashtu AK ka të drejtë për të vërtetuar dhe provuar saktësinë e të dhënave të Autorizimit të Prodhuesit.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

*Argumentimi:* Në bazë të pikës 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shtojca 9.**

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigja</b>
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	----- --
Numri NIPT/et:	----- ----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- -----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -----
E-mail:	----- -----

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

<b>Emri i nënkontraktorit të propozuar</b>	<b>NIPT – i</b>	<b>Përqindja e nënkontraktimit</b>	<b>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar</b>

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

<b>Emri (at) e subjekteve</b>	<b>NIPT-i</b>	<b>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</b>	<b>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</b>

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

## A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

<b>Deklarata</b>
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarimene vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:
etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
